

Njoftim për përqendrim me të cilin PROTEINI.SI SH.P.K, Slloveni, do të fitojë kontroll të plotë direkt mbi shoqërinë SANIVITA SH.P.K., Slloveni, dhe mbi asetet e T.H.E. dyqan për ushqim sportiv, sh.p.k, Slloveni

(lënda nr. 08-2/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), më datë 02.01.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrim me të cilin PROTEINI.SI SH.P.K, me seli në rr. Heroja Verdnika 22, 4270 Jesenice, Republika e Sllovenisë do të fitojë kontroll të plotë direkt mbi shoqërinë SANIVITA SH.P.K., prodhim i ushqimit sh.p.k, me seli në Zonën Industriale Ugar 19, 1310 Ribnica, Republika e Sllovenisë. Përveç fitimit të lartpërmendur të kontrollit, si pjesë e të njëjtit përqendrim paraqet transaksion të lidhur - shitblerja e aseteve, në T.H.E. dyqan për ushqim sportiv, sh.p.k, me seli në rr. Hrvashka ulica 10, 1000 Lubjana, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

PROTEINI.SI SH.P.K. vepron në tregun relevant të shitjes së ushqimit sportiv, suplementeve për ushqim sportiv dhe shëndet, veshje sportive dhe pajisje për stërvitje në Slloveni, me veprimtari të regjistruar të ndërmjetësimit të pa specializuar në shitjen e mallrave të ndryshme.

PROTEINI.SI SH.P.K është në pronësi të ALPE GEF SPORT SH.P.K, shoqëri për investime nga R. e Sllovenisë, e cila zotëron 100% të pjesëve dhe e cila është pjesë përbërëse e grupit të ashtuquajtur ALFI GROUP.

ALFI Group aktualisht ka një shoqëri të lidhur të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe atë: Shoqëri për tregti dhe shërbime APOLLO MK SHPKNJP Shkup me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 13 Shkup me veprimtari prioritare 46.49 - tregti me shumicë me mallra të tjera për amvisëri.

PROTEINI.SI SH.P.K realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes një marrëveshjeje franshize me shoqërinë GT SPORT SISTEM SHPKNJP Shkup për shitjen e ushqimit sportiv, suplementeve dhe shtesave, por kjo shoqëri nuk është e lidhur në asnjë mënyrë në aspektin e pronësisë me PROTEINI.SI SH.P.K.

SANIVITA SH.P.K vepron në tregun relevant të prodhimit të ushqimit të homogjenizuar dhe dietik.

SANIVITA SH.P.K nuk ka shoqëri të lidhura në R. Maqedonisë së Veriut nuk është aktive, as nuk ka realizuar ndonjë të ardhur në tregun e R.M.V.

T.H.E., dyqan për ushqim sportiv, sh.p.k vepron në tregun relevant të shërbimeve të shitjes me pakicë përmes porosisë me postë ose përmes internetit.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet si treg i prodhimit dhe shitjes së ushqimit sportiv, suplementeve dhe shtesave ushqimore.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka përcaktuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

08.01.2025

Shkup